




**LIGJI “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”
DHE TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSITË KUFIZUAR.
MOHIMI I PËRSHTATJES SË ARSYESHME
SI FORMË DISKRIMINIMI**



Version në gjuhë të thjeshtuar (easy-read)

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

RR. "Bogdani" , Nr1, Tiranë

Tel/Fax:+3554269426

www.adrf.al

E-mail:adrf@albmail.com

Disa nga figurat e këtij materiali janë prodhuar nga "Inspired Services Publishing Ltd"

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

ÇFARË KA NË KËTË GUIDË?

1	Cili është qëllimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi?.....	4
2	Çfarë është diskriminimi?	5
3	Çfarë është aftësia e kufizuar?	6
4	Cilat janë fushat ku ju mbron ligji për mbrojtjen nga diskriminimi?	7
5	Cilat janë mënyrat dhe format e ushtrimit të diskriminimit?	8
6	Çfarë është përshtatja e arsyeshme?.....	9
	● Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në arsim?.....	10
	● Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në fushën e punësimit?	11
	● Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në fushën e të mirave dhe shërbimeve?.....	14
	● Përshtatja e arsyeshme në situata rreziku, emergjencash humanitare dhe fatkeqësish natyrore.....	15
	● Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në raste pandemie?.....	16
	● Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në raste tërmeti?.....	16
7	Ku të ankoheni kur përjetoni diskriminim?	17

1

CILI ËSHTË QËLLIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI?



Të garantojë që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, pra njësoj, pavarësisht aftësisë së kufizuar që mund të kenë.



Kjo do të thotë që personat me aftësi të kufizuara duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat, njësoj si njerëzit e tjerë, si për shembull, të drejtën për kujdes shëndetësor, për të votuar, për të punuar, për të qënë të lirë, për të lëvizur, njësoj si të gjithë të tjerët.



Të trajtohesh në mënyrë të barabartë do të thotë që të kesh mundësi të njëjta për të bërë gjërat që dëshiron dhe mund të bësh.



Disa njerëz kanë nevojë për më shumë ndihmë që të bëjnë gjërat që ata dëshirojnë të bëjnë.

2

ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI?



Diskriminim do të thotë që dikush ju trajton keq ose në mënyrë të padrejtë vetëm sepse keni aftësi të kufizuara.



Diskriminim do të thotë të sillesh keq ose padrejtësisht me një person edhe për arsye të tjera, si për shembull të trajtohesh keq vetëm sepse je grua apo sepse i përket komunitetit rom.



Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendos disa rregulla që nuk lejojnë që njerëzit apo qeveria t'ju trajtojë keq apo në mënyrë të padrejtë, për shkak se je person me aftësi të kufizuara, grua, rom apo pjesë e ndonjë grupi tjetër.



Trajtimi i keq, për shembull mund të jetë kur nuk ju lejojnë të futeni në një spital, në një qendër, restorant apo në ndonjë zyrë, kur nuk ju pranojnë në shkollë, nuk ju marrin në punë sepse jeni person me aftësi të kufizuara.

3

ÇFARË ËSHTË AFTËSIA E KUFIZUAR?



Person me aftësi të kufizuar është ai person që ka dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat bashkë me barriera të ndryshme, që krijon shoqëria, e pengojnë pjesmarrjen e tij të plote dhe efektive në shoqëri.



Barriera janë pengesa, të cilat nuk lejojnë që një person me aftësi të kufizuar të jetë pjesë e shoqërisë, të jetoj në mënyrë të pavarur, të punoj, të udhëtoj, të ketë akses në ndërtesa.



Modeli i të drejtave të njeriut të aftësisë së kufizuar pranon se dëmtimet nuk duhet të konsiderohen si bazë legjitime për mohimin ose kufizimin e të drejtave. Duhet të garantojmë eliminimin e pengesave që krijon shoqëria që një person me aftësi të kufizuara të gëzojë të drejtat e njeriut njësoj si gjithë të tjerët.

4

CILAT JANË FUSHAT KU JU MBRON LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI?



ARSIM

Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq ose të mos pranoheni në shkollë sepse keni aftësi të kufizuara.



PUNËSIM

Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq në vendin e punës ose të mos pranoheni në punë sepse keni aftësi të kufizuar



SHËRBIME

Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq kur merrni shërbime apo kur bleni gjëra, si për shembull, në dyqane, banka, restorante, qendra sociale, kinema, zyra shtetërore apo të tjera, sepse keni aftësi të kufizuara.

5

CILAT JANË MËNYRAT DHE FORMAT E USHTRIMIT TË DISKRIMINIMIT?



Diskriminim i drejtpërdrejtë është atëherë kur ju mund të trajtoheni ndryshe, në krahasim me një person tjetër që nuk është me aftësi të kufizuara, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme.

Shembull *Një shkollë shtetërore, refuzon të pranojë një fëmijë me aftësi të kufizuara. Ky është një diskriminim i drejtpërdrejtë.*

Diskriminimi i tërthortë, është atëherë kur, edhe pse një sjellje apo një normë duket si e paanshme, në realitet, e vendos një person me aftësi të kufizuara në kushte jo të favorshme, në raport me të tjerët.

Shembull *Një kandidat me vështirësi në lëvizje është pranuar për një intervistë pune. Intervista është në një zyrë të katit të dytë në një ndërtesë pa ashensor. Megjithëse në dukje nuk kemi diskriminim, situata e vendos atë në një pozicion jo të pabarabartë me kandidatët e tjerë.*

Diskriminim për shkak të shoqërimit ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me një person me aftësi të kufizuara.

Shembull *Një nënë trajtohet në mënyrë të pafavorshme në punë, për arsyen se fëmija i saj është me aftësi të kufizuara.*

Shqetësimi është formë diskriminimi që ka të bëjë me një sjelljeje të padëshiruar, ndaj një personi me aftësi të kufizuara, që ka për qëllim cenimin e dinjitetit të personit, krijimin e një mjedisi frikësues, poshtëruës a ofendues për atë person.

Shembull Nëqoftëse jeni një person me aftësi të kufizuara dhe në vendin tuaj të punës keni një koleg i cili bën humor apo tallet vazhdimisht me aftësinë e kufizuar që keni, duke bërë kështu të mos ndiheni mire, ky është shqetësim, pra një formë tjetër e diskriminimit.

Mohimi i një përshtatje të arsyeshme, është formë diskriminimi

6

ÇFARË ËSHTË PËRSHTATJA E ARSYESHME?



Ndonjëherë ka nevojë që njerëzit apo qeveria të bëjnë ndryshime në mënyrë që të trajtoheni në mënyrë të barabartë.



Kjo është e vështirë për t'u bërë ndonjëherë nga njerëzit apo nga qeveria sepse mund të kërkojë shpenzim të parave. Kur kjo është shumë e vështirë apo e pamundur, quhet barrë e tepruar dhe njerëzit që kanë detyrë për të bërë këto ndryshime duhet të provojnë që e kanë shumë të vështirë ose të pamundur për t'i bërë këto ndryshime.



Këto ndryshime mund të jenë të vogla, si për shembull lëvizja e mobiljeve në zyrë që një person me karrike me rrota të lëvizë lirshëm, pa pengesa.



Një person që nuk shikon mund të ketë nevojë për ndihmë dhe mund të ketë nevojë për një tjetër person që e ndihmon ose për një kompjuter që lexon me zë.



Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në arsim?



Mjedis arsimor më pak kufizues



Plan të edukimit individual
(Plani i Edukimit Individual-PEI)



Mbështetje për të mësuar



Mësim të përshtatur



Materiale mësimore të përshtatura



Staf mësimor të specializuar



Mjedis / ambjente të përshtatura



Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në punësim?

Nëqoftëse ju mund të bëni pjesën më të madhe dhe të rëndësishme të punës si të tjerët, atëherë duhet tu ofrohet mundësia ta bëni këtë punë, pra të punësoheni.



Personi që ju ka marrë ose do t'ju marrë në punë duhet ta bëjë të përshtatur ambjentin në zyrë, në vendin ku ju punoni.



Të modifikojë/ndyshoj mënyrën se si ti të mund ta bësh një punë;

Shembull Një anketuesi mund t'i lejohej që t'i bëjë telefonatat përmes një linjë të caktuar nga shtëpia, në vend që t'i kërkohet që të vij rregullisht në një zyrë të papërshtatur/ të paaksesueshme për të realizuar këto thirrje.



Të modifikoj oraret e punës dhe oraret e pushimeve;



Të modifikojë ose të blejë mjete dhe pajisje;



Të modifikojë dhe politikat e ndërmarrjes;



psh:
të lejojë një person me aftësi të kufizuara
që të shoqërohet me një kafshë të
shërbimit ose qen guidë;

të lejojë ushqimin në vendin e punës për
një person me diabet;



të lejojë sende personale në tavolinën e një
personi me aftësi të kufizuara intelektuale
ose probleme të shëndetit mendor);



të sigurojë parkim të arritshëm për një
punonjës me aftësi të kufizuara;

Përshtatja e arsyeshme
duhet të realizohet:

- Në procesin e aplikimit.
- Kur jeni i punësuar
që të bëni sa më mirë punën
- Për të gëzuar përfitimet
e punësimit, njësoj si punonjësit
e tjerë që janë pa aftësi të kufizuara.
Psh akses në mencë, në vende ku
organizohen aktivitetet shoqërore etj.



Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në shërbime?

Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq ose në mënyrë të padrejtë kur merrni shërbime apo kur bleni gjëra, si për shembull, në dyqane, banka, restorante, qendra sociale, kinema, zyra shtetërore apo të tjera.

.....



Mjedis pa pengesa në shërbime bankare.

.....



Banesë e përshtatur.

.....



Të lejohet personi i verbër me qenin e tij guidë në një mjedis që ofron shërbime në komunitet.

.....



Transporti i përshtatur



Çfarë përfshin realizimi i përshtatjes së arsyeshme në situata rreziku, emergjencash e fatkeqësish natyrore?

Përshtatja e arsyeshme në rastin e një pandemie, si COVID-19

Përshtatja e arsyeshme apo masat mbështetëse janë thelbësore që personat me aftësi të kufizuara të zvogëlojnë kontaktet dhe rrezikun e kontaminimit.



Fushatat e këshillimit publik dhe informacioni nga autoritetet kombëtare të shëndetit duhet të jenë në formate të përshtatura.



Shërbimet shëndetësore të jenë të arritshme e të përshtatura.



Të ndihmoheni nga rrjetet mbështetëse dhe t'u ofrohen pajisjet ndihmëse.



Të keni të garantuara të ardhurat.




Autoritetet duhet t'u sigurojnë që mund të punoni nga shtëpia, dhe nëse kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së punës ose ndonjë arsye tjetër.

Përshtatja e arsyeshme në rastin e një tërmeti



Ndërgjegjësimit i pushtetarëve në nivel qendror dhe vendor për nevojat e personave me aftësi të kufizuara;



Mbledhja e të dhënave, edhe për personat me aftësi të kufizuara, sikurse për gjithë popullatën tjetër;



Shpërndarja e ndihmave të emergjencës edhe për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë mjetet ndihmëse, si karriget me rrota, paterica etj



Informacioni dhe mesazhet që ofrohen për pjesën tjetër të popullatës, duhet të jenë të përshtatura dhe të ofrohen edhe për personat me aftësi të kufizuara.



Ndërtimet e reja të jenë jo vetëm rezistente ndaj rreziqeve në të ardhmen, por edhe të përshtatura që të përmirësojnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara.



Ligji lejon që mund të trajtoheni me masa pozitive, si për shembull të keni përparësi ose favore në punësim. Kjo është e lejueshme dhe quhet trajtimi i ndryshëm i përligjur. Ky trajtim bëhet për t'ju ndihmuar dhe për të arritur barazinë.

6

KU MUND TË ANKOHENI NË RAST SE NDIHENI TË DISKRIMINUAR?

Nëse jeni trajtuar keq ose në mënyrë të padrejtë sepse jeni person me aftësi të kufizuara, mund të ankoheni te:



Mbledhja e të dhënave, edhe për personat me aftësi të kufizuara, sikurse për gjithë popullatën tjetër;



Mund të telefoni pa pagesë në numrin: 0 8 000 606

Tiranë

Adresa: Rruga e Durrësit Nr.27, Tiranë

Kodi Postar: 1019

Tel: + 355 04 243 1077

E-mail: info@kmd.al

Shkodër

Adresa: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13

Dhjetori, Nr.1

Kodi Postar: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Korçë

Adresa: Pranë Bashkisë Korçë, Rr:28

Nentori, Nr.1

Kodi Postar: 7001

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Fier

Adresa: ADISA, Lagjia 11 janari, „ Shtwpia
e Ushatrakwve“

Kodi Postar: 9301

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al



Ligji parashikon që mund të drejtoheni
edhe në Gjykatë ose në Prokurori.

Ju mund të ankoheni edhe në gjykatë dhe
prokurori vetë ose përmes një organizate
që mbron interesat tuaja.

